



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PËRGJITHSHËM**

U R D H E R

Nr. 72 date 01.03.2004

**EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE DHE MBIKËQYRJEN E VUAJTJES SË
DËNIMIT ME BURGIM**

Me synim, për të unifikuar praktikën dhe përmirësuar cilësinë e punës së prokurorit në ushtrimin e funksioneve:

- për ekzekutimin e vendimeve penale në Prokuroritë e të gjitha niveleve, si dhe;
- për mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit, duke garantuar respektirnin e të drejtave të të dënuarve me burgim;

Në mbështetje, të neneve 24 pika 4, 463-468 e vijues të K. Pr. Penale; të nenit 8 pika 2 të ligjit Nr. 8737 datë 12. 02. 2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"; si dhe të ligjit Nr. 8331 datë 21. 04. 1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" dhe në ligjin Nr. 8328 datë 16. 04. 1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim",

URDHEROJ:

**I. ORGANIZIMI I STRUKTURAVE PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE
PENALE DHE MBIKËQYRJEN E VUAJTJES SË DËNIMIT**

1. Në Prokuroritë e të gjitha niveleve të krijohen struktura organikë dhe/ose të caktohen prokurorë, për të ushtruar funksionet, në ekzekutimin e vendimeve penale, në mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit, në përfaqësimin e çështjeve në gjykatë që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale dhe në ekzekutimin e vendimeve penale në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, si in ë poshtë:
 - 1.1. Në Prokurorinë e rrethit gjyqësor Tiranë dhe në Prokurorinë për Krime të Rënda, të krijohet seksioni "Për ekzekutimin e vendimeve penale" në përbërje të cilit të jenë prokuror, oficer të policisë gjyqësore dhe sekretar/operator, numri i të cilëve të përcaktohet në vartësi të volumit të punës në ekzekutimin e vendimeve penale.
 - 1.2. Në Prokuroritë e rretheve gjyqësore, Durrës, Shkodër, Elbasan, Korçë, Fier, Vlorë, si dhe të rretheve gjyqësore Krujë, Mat, Lushnjë, Tepelenë, Lezhë, ku janë të vendosur institucione të vuajtjes së

dënimit me burgim, me ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri, të caktohet një prokuror, një oficer i policisë gjyqësore dhe një sekretar/operator.

1.3, Në Prokuroritë e rretheve të tjera gjyqësore, të caktohet një prokuror, një oficer i policisë gjyqësore dhe një sekretar/opetarot, të cilët ushtrojnë edhe funksionet që përcakton pika 1 e këtij urdhëri.

2. Prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe sekretarët/operatorët, që caktohen nga drejtuesi i Prokurorisë me ushtrimin e funksioneve në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, në vartësi të volumnit të punës, kryejnë edhe detyra të tjera që i ngarkohen prej tij.
 3. Në Prokuroritë e Apeleve, me ekzekutimin e vendimeve të menjëherëshme dhe të masave të sigurimit të urdhëruara nga Gjykata e Apelit, ngarkohen prokurorët që kanë përfaqësuar çështjen dhe oficeri i policisë gjyqësore i asaj strukture.
 4. Në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, organizohet Sektori i Ekzekutimit të Vendimeve Penale, i cili kryen funksione drejtimi, ndihme metodike dhe kontrolli/mbikëqyrje në ekzekutimin e vendimeve penale dhe vuajtjen e dënimit me burgim në shkaile vendi, si dhe ngarkohet me ekzekutimin e vendimeve të menjëhershme të Gjykatës së Lartë, të urdhëruara nga prokurorët e kësaj Zyre.
 5. Në Prokuroritë e të gjitha niveleve duhet të mbahet evidencë e sekretuar, për vendimet në ekzekutim dhe për dinamikën e fakteve të ndodhura në këtë fazë, të bëhet indeksimi i të dënuarve, si dhe të mbahet një fashikull i veçantë për çdo të dënuar, që i është ruajtur urdhëri i ekzekutimit
- 5.1. Evidenca "Për vendimet në ekzekutim", duhet të përmbajë: numurin rendor, emrin dhe mbiemrin e të dënuarit, llojin/et dhe masën e dënimit kryesor dhe dënimit plotësues, numrin dhe datën e vendimit gjyqësor, datën që vendimi ka marrë formën e prere, numrin dhe datën e shkresës së gjykatës që ka përcjellë vendimin, datën dhe orën e ardhjes së vendimit në prokurori, datën dhe orën e nxjerrjes së urdhërit të ekzekutimit, llogaritjen e kohëzgjatjes së qëndrimit në paraburgim në momentin e nxjerrjes së urdhërit dhe dënimi i mbetur për tu vuajtur, institucioni/vendi që caktohet të vuhet dënimi për dënimet me burgim, organet që ngarkoheu për kryerjen e ekzekutimit dhe që i dërgohet urdhëri; datën e njoftimit të urdhërit të të dënuarit dhe mbrojtësit të tij; numrin, datën dhe orën e njoftimit të organeve kompetente për fillimin e

ekzekutimit; numrin dhe datën e njoftimit që prokurori i bën gjykatës për fillimin e ekzekutimit, numrin dhe datën e njoftimit nga organet kompetente për përfundimin e ekzekutimit, numrin dhe datën që prokurori i bën gjykatës për përfundimin e ekzekutimit, kolonen për vërejtje të ndryshme, siç mund të jenë kërkesë për konvertim, masat e marra për mosnjoftimin e prokurorit etj.

- 5.2. Fashikulli për ekzekutimin e vendimit penal, përmban numrin respektiv të regjistrit, si dhe kopje të akteve si vijojnë: vendimin penal dhe shkresën përcjellëse që është sjellë për ekzekutim, urdhërin e ekzekutimit dhe kopjen e shkresës përcjellëse të urdhërit, konfirmimin e ardhur në prokurori nga organi kompetent për njoftimin e Fillimit dhe/ose përfundimin e ekzekutimit, njoftimin që prokurori i bën gjykatës për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit, procesverbale të mbajtura nga prokurori për verifikime në vendin e ekzekutimit, si dhe çdo akt tjetër procedural, kërkesë, ankesë, informacion apo akt tjetër shkresor që lidhet me ekzekutim e vendimit penal përkatës.

II. USHTRIMI I FUNKSIONEVE NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE PENALE DHE NË MBIKËQYRJEN E TIJ

1. Prokuroret e caktuar me ekzekutimin e vendimeve penale dhe me mbikëqyrjen e vuajtjes së dënimit, duhet të marrin në kohë të gjitha masat:
 - 1.1. për vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë ose të vendimeve me ekzekutim të menjëhershëm, në përputhje me urdhërimet e gjykatës dhe kërkesat e ligjit;
 - 1.2. për të mbikëqyrur rregullsinë e procedurave të ekzekutimit të vendimit;
 - 1.3. për të garantuar mbrojtjen dhe për të mbikëqyrur respektirninë të drejtave të dënuarve, veçanërisht të të dënuarve me burgim në institucionet e vuajtjes së dënimit;
 - 1.4. për të ndjekur gjatë ekzekutimit procesin e rehabilitimit të të dënuarve, si dhe;
 - 1.5. për të ndërhyrë në institucionet përkatëse ose për të paraqitur kërkesë në gjykatë në rastet kur duhet të rivendoset ligji ose e drejta e shkelur dhe për të vënë shkaktarët para përgjegjesisë disiplinore deri dhe penale.
6. Prokurorët duhet të kryejnë veprime përgatitore për fillimin e ekzekutimit të vendimeve penale, menjëherë sapo kopja e vendimit të formës së prerë i dërgohet nga gjykata ose terhiqet prej tij irie iniciativë në gjykatë, mbrenda afateve të përcaktuara në nenet 22 irxe 48 të ligjit Nr. 8331 datë 21. 04. 1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

7. Prokurorët fillojnë procedurën e ekzekutimit të vendimeve penale të formulimit të urdhërit të ekzekutimit. Urdhëri i ekzekutimit duhet të përmbajë: vendimin penal që vihet në ekzekutim, identitetin e saktë të të dënuarit, vendndodhjen/vendbanimin e tij të verifikuar, llojin dhe masën e dënimit kryesor që do të vuhet efektivisht, për të dënuarit me burgim edhe masën e dënimit të vuajtur deri në urdhërimin e ekzekutimit, institucionin/vendin e vuajtjes së dënimit për të dënuarit me burgim, Uojin e dënimit plotësues dhe kriteret e zbatimit të tij, detyrimin civil në procesin penal dhe shpenzimet procedurale në ngarkim të tij, si dhe organet që ngarkohen me ekzekutimin dhe/ose mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimit.

7.1. brenda 30 ditëve nga lëshimi i urdhërit të ekzekutimit, prokurorët duhet të njoftojnë mbrojtësin e të dënuarit, të zgjedhur prej tij ose të caktuar nga prokurori, prindin ose kujdestarin për të dënuarit e mitur, bashkëshortin për të dënuarit me fëmijë të mitur, në përputhje me nenin 14 të ligjit Nr. 8331 datë 21. 04. 1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

8. Në nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit të vendimeve penale, prokurorët duhet të respektojnë afatet e përcaktuara në nenet 21 dhe 49 të ligjit Nr. 8331 datë 21. 04. 1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" që duke filluar nga ardhja e vendimit në prokurori, janë:

- 8.1. menjëherë pas shpalljes, për vendimet me ekzekutim të menjehershëm të urdhëruara nga gjykata;
- 8.2. menjëherë dhe jo më vonë se 48 orë për dënimet me burgim ose mjekim të detyrueshëm në institucionet mjeksore, për të dënuarit që janë të paraburgosur;
- 8.3. jo më vonë se 72 orë, për të dënuarit me burgim të gjykuar në gjendje të lirë, si dhe;
- 8.4. brenda 5 ditëve, për dënimet me gjobë, të dhënë vetëm si dënim plotësues dhe për urdhërimet e tjera të gjykates;
- 8.5. pas përfundimit të dënimit kryesor, për dënimet plotësuese që nuk ekzekutohen njëkohësisht me dënimin kryesor

9. Prokurorët për ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikëqyrjen e tij, urdhërojnë organet që, sipas llojeve të dënimeve që vihen në ekzekutim, janë:

- 9.1. policitë e llojeve dhe strukturave të ndryshme të Policive, të cilat kanë detyra dhe përgjegjësi për të kryer veprimet e urdhëruara për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe dënimet plotësuese, siç janë:
 - a. ndalimi për të drejtuar automjete;
 - b. ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative, si dhe;

- c. nxjerrja jashtë territorit;
- 8.2. zyrat e përmbartimit gjyqësor, që kanë detyra dhe përgjegjësi për kryerjen e veprimeve të urdhëruara për ekzekutimin e dënimit me gjobë, konfiskim të mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe përfitimeve që rrjedhin prej saj, punën në interes publik, shpenzimet gjyqësore dhe detyrimin civil të caktuar në vendimin penal, si dhe;
- 8.3. organet shtetërore ose subjektet e tjerë juridik shtetërore ose privat, të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi për ekzekutimin e vendimeve dhe dënimeve plotësuese të urdhëruara siç janë:
 - a. ndalimi i të drejtës për të ushtruar detyra si nëpunës shtetëror ose në shërbim publik;
 - b. heqja e dekoratave dhe e titujve të nderit, si dhe;
 - c. heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë
- 10. Për ekzekutimin e vendimeve penale ndaj shtetasve të huaj ose pa shtetësi, sipas llojit të dënimeve dhe në veçanti të dënimit plotësues "Nxjerrja jashtë territorit", prokurorët duhet të njoftojnë Ministrinë e Drejtësisë, e cilat duhet të njoftojë Drejtorinë Konsullore në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Prokurorët, gjithashtu, duhet të venë' në dijeni edhe Sektorin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm.
- 11. Prokurorët duhet të sigurojnë njoftim nga subjektet e urdhëruara me ekzekutimin e vendimeve penale, për faktet dhe rrethanat që ndikojnë në mënyrën dhe kohën e ekzekutimit të një vendimi penal, si dhe për fillimin dhe përfundimin e ekzekutimit të vendimeve penale.
- 12. Me marrjen njoftim nga organet e ngarkuara për vënien në ekzekutim të vendimeve penale dhe për përfundimin e dënimit, prokurorët duhet të njoftojnë gjykatën për fillimin e ekzekutimit dhe për përfundimin e dënimit, duke bërë shënime edhe në evidencën përkatëse.
- 13. Prokurorët në fazën e mbikqyrjes së ekzekutimit të vendimeve penale duhet të ushtrojnë të gjitha funksionet e përcaktuara në ligj, duke mos e konsideruar të përfunduar detyrën e tyre ligjore vetëm me nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit të vendimit, por duhet:
 - 13.1 të kërkojnë informacionin e duhur në rastet kur nuk konfirmohet ekzekutimi i vendimit penal nga organet e urdhëruara për vënien në ekzekutim;

13.2 evidentojnë, në çdo kohë, sipas veprave penale, të gjithë penonat e dënuar me vendime gjyqësore të pa ekzekutuara;

13.3 në bashkërendim me organet e urdhëruara për ekzekutim, të analizojnë periodikisht, çdo muaj, shkaqet dhe përgjegjësit e moszekutimit të vendimeve penale, si dhe të kërkojnë marrjen e masave disiplinore dhe administrative ndaj shkaktarëve, duke parashtruar këto kërkesa organeve të emërtesës, si dhe duke kërkuar prej tyre njoftim për masat e marra.

III VEÇORI NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE ME BURGIM

1. Me marrjen formë të prerë të vendimeve penale me burgim, prokurorët nuk duhet të qëndrojnë në pritshmëri të gjykatës për marrjen e vendimeve, por me iniciativë të kërkojnë zyrtarisht ose ti tërheqin ato në gjykatë për ti vënë në ekzekutim, duke u siguruar që nuk është vendosur pezullimi apo shtyrja e ekzekutimit të tyre.
2. Prokurorët, për fillimin e ekzekutimit të vendimeve me burgim, duhet të kryejnë disa veprime përgatitore, për të verifikuar, vlerësuar dhe përcaktuar saktë në urdhërin e ekzekutimit, sa më poshtë vijon:
 - 2.1. nëse vendimi është i ekzekutueshëm apo është parashkruar ekzekutimi i dënimit sipas nenit 68 të K. Penal. Ky verifikim është i domosdoshëm edhe në rastet e rivënies në ekzekutim të dënimeve të ndërprera.
 - 2.2. kohën për vuajtjen e dënimit. Për të dënuarit e paraburgosur saktëson kohën e dënimit të vuajtur dhe pjesën e dënimit që mbetet për tu vuajtur, në përputhje me nenin 57 të K. Penal;
 - 2.3. llojin e institucionit ku i dënuari do të vuaj dënimin me burgim, nëse mund të jenë burg i sigurisë së lartë, i sigurisë së zakonshme ose i sigurisë së ulët apo institucion i veçanta.
 - 2.4. institucionin konkret të vuajtjes së dënimit me burgim, duke e saktësuar atë që më parë, me kërkesë zyrtare nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;
3. Në rastet e të dënuarve për krime të rënda apo të organizuara ose të të dënuarve të tjerë që vlerësohet se vuajtja e dënimit duhet të bëhet në burg të sigurisë së lartë dhe vendimi i gjykatës nuk e ka bërë këtë përcaktim, prokurori duhet të paraqesë kërkesë gjykatës për caktimin e burgut të sigurisë së lartë si vend i vuajtjes së dënimit.
4. Në rastet kur vlerësohet se i dënuari duhet të vendoset në institucione të veçanta dhe vendimi i gjykatës nuk i ka përcaktuar, prokurori duhet të

urdhërojë kontrollin mjekësor të të dënuarit dhe vepron në vartësi të rezultatit që konkludohet nga akti i kontrollit mjekësor.

5. Urdhërat e ekzekutimit të vendimeve me burgim, prokurorët, menjëherë, duhet t'ia dërgojnë organeve të ngarkuara me ekzekutimin e tyre, që sipas rastit dhe subjektit të veprës penale, mund të jenë:

- 5.1. policia e institucionit ku personi ndodhet në paraburgim, kur i dënuari është i paraburgosur;
- 5.2. policia e rendit të Komisariatit ose të Drejtorisë së Policisë, të vendit ku ka vendbanimin, qëndrimin e përhershëm ose të përkohëshëm, kur i dënuari me burgim është i lirë;
- 5.3. Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kur vendbanimi ose vendndodhja e të dënuarit me burgim nuk dihet, si dhe;
- 5.4. policia ushtarake - seksionet ose nënseksionet pranë repartit ku ka qenë ushtarak efektiv i dënuari ose të repartit ku ai ndodhet, për të dënuarit ushtarak apo Bataljonit të Policisë Ushtarake në Tiranë.

I. VEÇORI NË USHTRIMIT E FUNKSIONEVE NË MBIKËQYRJEN E VUAJTJES SE DËNIMIT ME BURGIM.

- 1 Prokurorët duhet të mbikëqyrin vuarjtjen e dënimit me burgim, në institucionet e vuarjtjes së dënimit dhe të paraburgimit, që ndodhen në teritorin e rrethit gjyqësor të Prokurorisë, për të garantuar respektimin e të drejtave dhe trajtimin me dinjitet të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.
- 2 Mbikëqyrja në burgjet e sigurisë së lartë, i delegohet prokurorit të seksionit të ekzekutimit të vendimeve penale të Prokurorisë për Krime të Rënda.
- 3 Prokurorët, kur e çrnojnë të nevojëshme, të shoqëruar edhe me specialistë të fushave përkatëse, duhet të mbikëqyrin drejtpërdrejt institucionet e ekzekutimit të dënimeve me burgim, si rregull një herë në muaj, ose me shpesh pa paralajmërim, duke:
 - 3.1 pranuar ankesa dhe kërkesa, me shkrim ose drejtpërdrejt, nga të dënuarit, Këshilli Mbikëqyrës ose nga persona që kanë statusin e vizitorit, ose;
 - 3.2 verifikuar dokumente, në objekte, pajisje dhe mjedise brenda dhe jashtë institucionit të vuarjtjes së dënimit, që kanë lidhje me të dënuarit.
4. Gjatë mbikëqyrjes së vuarjtjes së dënimit me burgim, duke vlerësuar kriteret

ligjore, kushtet, rrethanat dhe gjendjen e të dënuarit dhe dokumentacionin përkatës, prokurori mund të urdhërojë:

- 4.1. transferimin e të dënuarit nga një burg i sigurisë së zakonshme në një burg të sigurisë së ulët dhe nga një burg të sigurisë së ulët në një burg të regjimit të zakonshëm, duke miratuar ose refuzuar kërkesën e drejtorit të burgut, në përputhje me nenet 14 e 15 të ligjit Nr. 8328 datë 16. 04. 1998 ^aPer të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim";
 - 4.2. vendosjen e të dënuarve të sëmurë ose me shqetësime mendore apo psikike në institucionet për të sëmurët dhe të paaftët, si dhe daljen prej tyre, duke miratuar ose refuzuar propozimin e drejtuesit të institucionit, sipas nenit 16/2-3 të ligjit të lartpërmendur;
 - 4.3. vendosjen e të dënuarve që kanë profesione të lidhura me mjekësinë, në institucionet për të sëmurët dhe të paaftët, kur për ta nuk ka pengesa ligjore, sipas nenit 16/6 të ligjit të lartpërmendur;
 - 4.4. transferimin e të dënuarit për mjekim në spitalin e burgut dhe kur është e nevojshme edhe në institucione të tjera mjekësore, kur mjekimi i tij nuk mund të bëhet nga shërbimi shëndetsor i institucionit, në bazë të nenit 33 të ligjit të lartpërmendur;
 - 4.5. dhenien ose zgjatjen e lejes së veçantë të të dënuarit, për të qenë të pranishëm në raste vdekjeje ose për ngjarje të rëndësishme familjare, kur dhënia ose zgjatja e lejes refuzohet nga drejtori i institucionit, në përputhje me nenin 60 të ligjit të lartpërmendur;
 - 4.6. miratimin e kërkesës së drejtuesit të institucionit, për përdorimin mbi 72 orë, të mjeteve të shtrëngimit fizik ndaj të dënuarve, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 57 të ligjit të lartpërmendur.
5. Në çdo rast, pavarësisht nëse konstaton shkelje apo parregullsi, prokurori duhet të mbajë procesverbal, për mbikëqyrjen dhe verifikimet e kryera në institucionin e vuajtjes së dënimit me burgim, sipas nenit 70 të ligjit të lartpërmendur.
- 5.1 Procesverballi duhet të nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij.
 - 5.2 Kopjet e procesverbalit të administrohen në një fashikull të veçantë dhe në fashikullin përkatës të të dënuarit
6. Për konstatimet dhe për parregullsitë apo pengesat në ushtrimin e funksionit të mbikëqyrjes së vuajtjes së dënimit me burgim, prokurori, në përputhje me nenin 69/2 të ligjit të lartpërmendur, duhet të paraqesë kërkesë drejtorit të institucionit:
- 6.1. për rivendosjen e menjëhershme të ligjit apo rregullit të shkelur;
 - 6.2. për realizimin e të drejtës së të dënuarit, si dhe;

- 6.3. për nisjen e procedimit disiplinor, administrativ apo të zhdëmtimit ndaj shkaktarëve.
7. Në rastet kur kërkesa e prokurorit nuk merret në konsideratë nga drejtoria e institucionit, si dhe kur rivendosja e ligjit, rregullit apo e së drejtës të shkelur është në kompetencë të gjykatës ose organeve të tjera, të përcaktuara në ligj, prokurori, në bazë të nenit 69/3 të ligjit të lartpërmendur, duhet tia parashtrojë çështjen ose kërkesën për shqyrtim organeve përkatëse.
8. Në rastet kur shkeljet ligjore të evidentuara në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale dhe të mbikëqyrjes së vuajtjes së dënimit me burgim perbejnë vepër penale, prokurori mbi bazën e kallëzimit ose ankimit apo kryesishtë duhet të regjistrojë fillimn e procedimit penal dhe të ushtrojë ndjekje penale ndaj personave përgjegjës.

V. USHTRIMI I FUNKSIONEVE TË TJERA NGA PROKURORI NË FAZËN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE.

1. Prokurorët e caktuar me ushtrimin e funksioneve në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, krahas përcaktimeve në zbatim të këtij urdhëri, në ekzekutimin e dënimit me gjobë, alternativave të dënimit me burgim, dënimeve plotësuese, masave mjekësore edhe edukuese, në shqyrtimin gjyqësor të çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe në ekzekutimin e vendimeve penale të huaja duhet të mbështeten në:
- 1.1. nenet 462 - 480 dhe 512 - 523 të K. Pr. Penale;
 - 1.2. nenet 33, 34, 44, 46, 56, 57, 58-65, 68 e vijues të K. Penal;
 - 1.3. nenet 517, 519 e vijues në Pjesën e Katër të K. Pr. Civile.
 - 1.4. ligjin Nr 8331 datë 21.4.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", F.Z. nr. 12, viti 1998;
 - 1.5. ligjin Nr. 8328 datë 16. 04. 1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", F.Z. nr. 11, viti 1998;
 - 1.6. ligjin Nr. 8092 datë 21. 03. 1996 "Për shëndetin mendor", F.Z. nr. 12, viti 1996;
 - 1.7. Konventën e Këshillit të Europës "Për transferimin e personave të dënuar", ratifikuar me ligjin Nr. 8499 datë 10. 06. 1999, F.Z. nr. 22, viti 1999;
 - 1.8. Konventën Europiane "Për Mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht", ratifikuar me ligjin Nr. 8724 datë 26. 12. 2000: F.Z. nr. 50, viti 2000;

- 1.9. Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve të miratuar me vendimin e KM Nr. 63 datë 9. 03. 2000, F.Z. nr. 6/1, viti 2000;
- 1.10. Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit te paragurgimit" miratuar me urdhër, Nr. 3750/2 datë 23. 07. 2003, të Ministrit të Drejtësisë dhe në Rregulloren e Brendëshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me urdhërin Nr. 4595 datë 15. 07. 2003 të Ministrit të Drejtësisë, si dhe;
- 1.11. akte të tjera ligjore dhe nënligjore rië këtë fushe të dalë në zbatim të tyre.

VI. ZBATIMI DHE PËRGJEGJËSIA PËR SHKELJET

1. Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe operatorët e ngarkuar me ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe drejtuesit e Prokurorive të të gjitha niveleve dhe të strukturës së Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Për punën e bërë në drejtimet e mësipërme, për vështirësitë dhe problemet që ndeshen në ekzekutimin e vendimeve penale dhe zbatimin e këtij urdhëri, veç statistikës, çdo 3-mujor, të dërgohen të dhëna dhe informacion me shkrim në sektorin përkatës të kësaj Zyre.

VII. HYRJA NË FUQI

2. Urdhëri Nr. 114 datë 10. 06. 2002 "Për disa probleme në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë me burgim" dhe çdo akt normativ i kësaj Zyre që bie në kundërshtim me kërkesat e këtij urdhëri, shfuqizohet.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU

